

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN, gjyqtari Refki Piraj, me procesmbajtësen Halime Nixha, sekretare juridike e kësaj gjykate, në lëndën penale kundër te pandehurit H. T. nga M. , për shkak të veprës penale pengimi i personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare nga neni 409 par.2. të KP, i akuzuar sipas aktakuzës së PTH ne Prizren PP.nr.4042/12 të datës 15.05.2013 në prezencën e të akuzuarit, Prokurorit të Shtetit Beqë Shala, më dt.25.09.2017 muar dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

H. T. i lindur me *data e lindjes..* ne fsh.M. ku edhe jeton, nga i ati Hajrulla dhe e ëma Gjylije, ka te kryera 5 klase te shkollës fillore, i martuar babe i 1 femiu, bujk, i gjendjes se dobët ekonomike, shqiptar - shtetas i R te Kosovës

ËSHTË FAJTOR

Me datën 29.10.2012 rreth orës 12,00 ne stacionin policor në M., se bashku me nje grup te personave, pengojnë personat zyrtar ne kryerjen e detyrave zyrtare, ne ate mënyrë qe posa kuptojnë se H. T. vëllai i te pandehurit te dyte eshte arrestuar nga ana e policisë se bashku me personat e tjerë shkojnë ne stacionin policorë ne M. dhe tentojnë qe me force te hyjnë brenda dhe ta lirojnë te pandehurin H. T.

Këso dore ka kryer veprën penale pengim i personit zyrtar ne kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 409 par.2 - 31 te KP-së.

Andaj gjykata ne kuptim te nenit 3, 4, 41, 43, 46 te KP te pandehurit i shqipton

DËNIM ME GJOBË

Ne shume prej 200 euro te cilën shume duhet te paguaj ne xhirollogarinë e kësaj gjykate nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, e po qese dënimi me te holla nuk mund te paguhet nga ana e te akuzuarit ne afatin e sipërpërmendur I njëjti do te zëvendësohet me dënim burgu duke llogaritur 20 euro per 1 dite burg, qe do te thotë 15 (pesëmbëdhjetë) dite burg.

Të dëmtuarit L. R., A. F., M. B. dhe L. B. zyrtar ne SP ne M. per realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen ne kontest civil.

Obligohen te pandehurit qe te paguajnë te gjitha shpenzimet e procedurës sa ato te bëhen ne baze te llogarisë se gjykatës kurse ne emër te paushallit gjyqësor secili te paguan Shumen prej nga 20 euro te gjitha këto ne afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi nen kërcënim te ekzekutimit te dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Prizren ka parashtruar aktakuzën PP.nr.4042/12 të datës 15.05.2013, kundër të pandehurit H.1 T., H. T.2 dhe V. T. te gjithë nga M. , për shkak të veprës penale pengimi i personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare nga neni 409 par.1-2. të KP.

Me aktvendimin P.nr.758/13 te dt.10.06.2016 gjykata veçon procedurën ndaj këtu te akuzuarit H. T.2 me qenese i njëjti ne ate kohe gjendej jashtë vendit.

Në shqyrtimin fillestar i pandehuri H. T.2 në tërësi e ka pranuar veprën penale e cila i vihjet në barrë sipas aktakuzës , e po ashtu kanë pranuar edhe fajësinë .

Gjyqtari gjykues konforme dispozitave te nenit 248 te KPP-së përcakton e te akuzuarit te cilët kane pranuar fajësinë i kane kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit, pranimi është i vullnetshëm dhe mbështetet ne faktet e çështjes, kurse aktakuza nuk permban asnjë shkelje te qarte ligjore, andaj ka pranuar pranimin e fajësise, andaj me aktvendim ka pranuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit.

Kjo gjykatë gjeti se në veprimet e të akuzuarit , plotësohen të gjitha elementet qenësore te veprës penale pengimi i personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare nga neni 409 par.2 të KP, prandaj dhe iu shqiptoi dënimit me gjobë duke qenë e bindur se me këtë lloj dënimi do te arrihet qëllimi i të njëjtit.

Me rastin e shqiptimit të dënimit për veprën penale gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat të cilat në kuptim të nenit 73 të KP ndikojnë në përcaktimin e lartësisë së dënimit.

Gjykata çmoi rrethanat lehtësuese dhe rënduese secilën në veçanti dhe lidhshmërinë në mes të tyre me të gjitha rrethanat tjera të cilat ishin me ndikim në përcaktimin dhe qëllimin e dënimit.

Si rrethana randuese gjykata kishte parasysh intenzitetin e rrezikimit apo dëmtimin e vlerës së mbrojtur kurëse në rrethanat lehtësuese pranimin e fajit për veprën dhe rrethanat familijare.

Vendimi mbi udhëzimin ne kontest civil u muar ne kuptim te nenit 463 par.2 te KPK.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është mare ne kuptim te nenit 450 dhe 452 te KPPK-se.

Më sa u tha më lartë u vendos si ne shqiptim të ketij aktgjykimi .

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN P.nr.1627/16, e datës 25.09.2017

Procesmbajtësja:
Halime Nixha

Gjyqtari:
Refki Piraj

DHËZIME JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, mund të ushtrohet ankes, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit ne Pristine , e nëpërmjet të kesaj gjykate.